

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME LINDA GUSIËN

Prishtinë | Data: 9 shkurt, 2026

Kohëzgjatja: 90 minuta

Të pranishëm:

- Linda Gusia (E intervistuar)
- Noa Nikqi (Intervistuesja dhe Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Linda Gusia: Une jom Linda Gusia. Jom lindë edhe jom rritë n'Prishtinë, kom jetu n'Prishtinë pjesën ma t'madhe t'jetës tem. Jom rritë n'kohna interesante... në kohën e Jugosllavisë socialiste, në kohën e shpërbërjes t'Jugosllavisë, në kohën e ni shoqnie komplet t'segregume që ka qenë si apartheid, në kohën e luftës, në kohën e masluftës, edhe tash në kohna te kriznave të ndryshme globale. Kshtuqë ndihna që e kom pasë një jetë dinamike edhe një jetë pak a shumë të formësime me shumë ngjarje t'mdhaja në ni ven shumë t'vogël.

Domethonë, në shkollën fillore veç kan fillu tensionet politike. Une kom shku në shkollën Vladimir Illyich Lenini, edhe në atë shkollë në 1989tën, në 1 shtator, u patëm kthy n'shollë në klasën e 7, po m'duket, 6-tën-7-tën, me ni mur mes serbve edhe shqiptarve, ni shkollë e cila veç e fillon qat procesin e ndarjes.

Marsi i 89-tës ka qenë vit i cili ka qenë brutal. M'kujtohet kur jemi qu prej gjumit shumë herët në mëngjes prej zhurmës t'tankeve tu hi n'Prishtinë ka Dardania. Une jom rritë n'Dardani, e kemi pasë banesën në kat t'7-të me ni pamje k'shtu te kjo rruga ka Bill Clintoni. Edhe m'kujtohet që u patëm qu në mëngjes me mamin e me babin tu kqyr prej dritare, në ni ditë shumë t'zymt, tu hi tanket në mars t'1989, ku osht marrë autonomia e Kosovës.

Mendoj që qajo ditë, edhe qato ngjarjet e marsit t'89-tës, me krejt protestat, demonstratat, n'fakt ka fillu prej shkurtit me minatorët. Kan fillu edhe ma herët n'88-tën me minatorët, në protestat n'nëntor t'88-tës. M'kujtohet qyteti me nifar zymtësie, ngulfatje edhe sensi t'madh t'klaustrofobisë në 88-tën e 89-tën. M'kujtohet nifar vit i ri ma i zymt se viteve tjera, nifar pasigurie n'përgjithësi. Edhe marsi – po menoj edhe krejt fillimi i 89-tës – me shumë shumë protesta.

E kom kështu të ngulitun n'kokë kur pat ardhë axha jem edhe krejt kusheritë e tjerë prej Peje si puntorë t'Trepçës, fabrikës së baterisë n'Pejë “Trepça”, që jon nisë n'kamë edhe n'krejt Kosovën që jon nisë n'kamë për me ardhë n'Prishtinë, për me e mbrojtë autonominë e Kosovës edhe për me i dalë n'krah n'shkurt minatorve n'atë kohë. M'kujtohet kur ka hy n'banesë te na edhe i ka pasë kambët qaq t'ajuna edhe qaq t'ngrita, se ka qenë ftoft, sa kemi pasë shumë mundim me ja hekë kpuat prej kamve. Edhe m'kujtohet që i majke kamt n'ni legen t'nxehetë për me ju shkri.

Për mu ka qenë nifar asi momenti ku e kom pa n'forma të ndryshme t'angazhimit t'njerëzve që noshta edhe s'kan qenë shumë politik. Domethonë, axha jem nuk ka qenë kështu politik, ka qenë puntorë n'Trepçë, osht' nisë me kolektivin e ti.

Domethonë, qajo marsi, krejt qato dinamika, edhe kthehemi n'shkollë me 1 shtator, edhe osht një murë mes anës shqiptare edhe anës serbe. Na e kemi pasë shkollën e re, e kemi pasë shkollën me dy hymje, edhe pjesa ma e mirë e shkollës ka metë n'anën e serbve, domethonë pjesa ku ka qenë biblioteka e shkollës, pjesa ku ka qenë laborator i biologjisë, laborator i kimisë. E na që kemi qenë si me thonë 90% t'shkollës, kemi metë n'ket gjysën tjetër, e tash me klasa shumë t'ngarkume, me drejtor tjetër, apo me drejtorin e vjetër që pat vazhdu. Drejtori i ri, na i thojshim “drejtori i dhunshëm”.

Në anën tjetër, domethonë, protesta, helmime. Helmimet sidomos që fillojnë poashtu n'89-tën, helmimet nëpër shkolla, kanë qenë poashtu ni etapë e shkollës fillore që e maj n'mend. Qajo friga, qajo ideja e a pe din, a po vjen naj erë e keqe, a mos kan gjujt. Mandej vazhdimisht me pa n'televizor çka osht tu ndodhë. Po ka qene poashtu nifar periudhe që, deri atëherë hymja jonë ka qenë hymje me shum serb, shqiptar, boshnjak, turq, a po. Hymja jonë ka qenë hymje e qe ka reprezentu qatfar shumëkombësinë në Jugosllavi.

Mirëpo, domethonë, momentin e qityne ngjarjeve m'kujtohet shumë qartë kur ka qenë kojshija i katit t'tretë në televizion, i cili ka qenë shumë i dashtun me neve. Njoni topolak që vijke me na marrë sene zakonisht, me na lypë, qysh lypshin kojshitë përpara. Edhe pe shoh në televizion tu thonë që shqiptarët jon aktorët ma t'mirë n'bote, që helmimi nuk po ndodhë, që shqiptarët veç po aktrojnë. M'kujtohet si nifar momenti ku une si fmi i vogël e kom thirrë nanën tu i thonë: “Kqyre, kojshija jonë çka po flet”. Nana jem s'ka qenë shumë e befasume. A po.

Për mu ka qenë diqysh si dikush që e njoh edhe dikush që në perceptimin tem si fmi ka qenë ni njeri që nuk munet me pasë qikaq shumë urrejtje për shqiptarët, kur ai flet mirë me neve edhe na jemi shqiptar. Kan qenë do qisi momente t'vogla ku qato qarjet e mdhaja mes dy komuniteteve kanë ndodhë, që masanej mo vetëm në mënyrë shumë t'heshtun u patëm nalë edhe s'folshim mo me njoni-tjetrin.

E njejta gja edhe me ni shoqe tjetër që e kom pasë në kat, Nadica. Nadica ka qenë diqysh ni qikë që kena qenë moshatare, kena shku n'të njejtën shkollë. Shumë shpesh kena shku n'shkollë bashkë. I kena pasë prind't te dyjat n'punë tan ditën edhe kena qenë tu nejt vet në pjesën ma t'madhe t'ditës, kshtuqë shumë shpesh kena shku te njona-tjetra me kqyr Branko Kockicën. Edhe me Nadicën, mas qityne ngjarjeve t'99-tës, ka qenë nifar ashtu. Nuk ka pasë përplasje, nuk ka pasë kurrfar mospajtimi. Kur e menoj n'retrospektivë, ka qenë e çuditshme. S'ka pasë ballafaqim, s'ka pasë kurrfar, as akuza as diskutime, po veç ka qenë nifar si ndarje edhe ni ndjenjë që s'ka pasë çka mu thonë, a po. Si nifar ndarje mbrenda qatyne grupeve etnike, po edhe nifar politizimi.

Mu m'kujtohet që ka qenë shumë- koha kur babi, sidomos tu punu n'Rilindje n'atë kohë, bijke shumë gazeta. Bijke krejt gazetat edhe shqip edhe serbisht edhe ka pasë gazeta t'ish-Jugosllavisë. Edhe sidomos n'90-tat fillojnë luftnat. Fillon lufta n'Kroaci, mandej lufta n'Bosnie. Edhe domethonë, n'shpi

kemi pasë gjithmonë shumë gazeta t'vendeve t'ndryshme t'Jugosllavisë. Edhe mu m'kujtohet që domethonë çdo herë i kom lexu edhe qaty ka qenë nifar interesimi jem për politikë, sepse ka qenë nifar nevojë shumë e madhe me kuptu, a po, qat shpërbërjen. Edhe me neve si f'mi nuk kan folë shum.

M'kujtohet që gjithmonë ka qenë n'7:30 lajmet kryesore. Gjithmonë ka qenë nifar “shhh”. Domethonë, nuk kemi guxu me bo zhurmë, nuk kemi guxu me u përta me vllaun tem Jetonin. Domethonë, ka qenë koha ku n'7:30 u konë kohë e heshtjes totale. Edhe prind't tonë me nifar ankthi t'jashtëzakonshëm kan dëgju lajme edhe jon mundu me i interpretu edhe dekodu çka po thojn lajmet.

N'atë kohë edhe shum prej lajmeve kan qenë në gjuhë shum rigjide edhe të kujdesshme. Ka qenë ni ven i cili, domethonë, Jugosllavia ka pasë nifar lirie ma t'madhe se ndoshta vendet tjera socialiste për mendime politike, po kur ka ardhë te shqiptarët edhe sidomos manifestimi i çfarëdolloj qëndrimi politik pro shqiptar osht pa përherë si me dyshim. Osht' pa përherë si me dyshim, osht' pa perherekëta i thojshin irredentizëm, separatizëm. Osht' pa përherë si tendencioz edhe osht' pa përherë si jashtëzakonisht shume i dënueshëm.

Kshtuqë kujdesi për mënyrën se si po fliten senet, sidomos në media, po edhe në mënyrën se si po fliten n'shtepi, në mënyrë që edhe mos me na frigu neve, ka qenë kështu ni, domethone, ni proces i madh i kodimit, dekodimit t'asaj çka po thuhet, çka po nënkuptohet. Edhe ka qenë ni periudhë ku, domethonë, ti e shihshe sistemin tu u shemb para syve t'tu, a po. Edhe e shihshe, domethonë, krejt fillimi i 90-tave m'kujtohet me shumë lajme. Domethonë, të gjitha seancat në kuvendin e partisë komuniste jon kqyrë ashtu prej fillimit deri në fund.

M'kujtohet kështu në mënyrë shume eksplicite Kaqusha Jashari edhe guximi i Kaqusha Jasharit kshtu, edhe brohoritja kshtu n'shpi: “Aha po, mirë ja boni. Bravo!” Domethonë, për një politikane gru e cila i kthehet Millosheviqit edhe në mënyrë shum të drejtpërdrejtë i thotë: “Ulu, ndegjom.” Edhe në nifar menyre ballafaqohet me autoritetin, Luljeta Pula, e cila ka qenë kojshike e jemja ne kat të tretë poashtu, dhe grate si Luljeta grate si Kaqusha, kanë qenë nifar si shembull i ri i guximit edhe ma të madh se guximin qe poltikant burra e kishin, sidomos politikant burrat e integrumë ne sistem, a po.

Luljeta nuk ka qenë- Luljeta ka ardhë prej kështu-Luljeta ka qenë profesoreshë. Nuk ka qenë pjesë e partisë komuniste. Luljeta ka qenë kështu si demokrate. Po guximi, për shembull, i Tezës Lule, i thojshim na, se për neve ka qenë Teze Lule, ka qenë i jashtëzakonshëm. Për shembull, me folë për helmime. Edhe mu m'kujtohet kështu, domethonë respekti i jashtëzakonshëm edhe krenaria e jashtëzakonshme që e kemi ni t'gjithë hymja kur Luljeta Pula ka shku në emision në Beograd dhe ka folë për helmimin në Beograd edhe ka folë për faktin se si helmimi ka ndodhë n'Kosovë edhe çka osht tu ndodhë në Kosovë në televizionin në Beograd, me nifar elokuence edhe guximi të jashtëzakonshëm.

Për mu ka qenë kështu ni shembull i jashtëzakonshëm i integritetit politik edhe guximit edhe elokuencës. Edhe ka qenë dikush që i ki thonë Teze Lule ton jetën edhe ka qenë nifar familiariteti që t'ka bo me u ndi edhe si ma afër edhe pjesë e qatyne seneve.

Domethonë t'90tat kan qenë qashtu. Jashtëzakonisht politike, jashtëzakonisht dinamike, jashtëzakonisht me qisi ngjarje t'cilat n'forma të ndryshme na kanë formesu. Une edhe Mimoza Jupa, shoqja jeme e ngushtë e shkollës, mandej t'shkollës t'mesme kemi qenë mandej poashtu shumë të interesume me politikë. Po mendoj, nji prej arsyeve pse kemi qenë shoqe t'ngushta osht' se kemi qenë shumë të interesume në ata se çka po ndodhë edhe kemi qenë të dyjat kështu tu u munu me gjete copëza të ndryshme edhe me lexu. Edhe qajo na ka bo shoqe edhe na ka ndërlihdë.

Kshtuqë m'kujtohet që vazhdimisht e kemi pasë edhe nifar rebelizmi, kështu, kundër asaj se çka po ndodhë në kontekstin n'të cilin jemi rritë. Kemi shku bashkë në shkollën Sami Frashëri. Une domethonë e kom fillu shkollën e mesme në shtator të 1992-tës. Edhe ka qenë si viti- jo, në fakt në shtator s'e kom fillu, m'fal, se shtatori ka qenë shkolla e mbyllun. Qitash s'osht tu mu kujtu.

Noa Niqki: Kur fillon pjesa e shpijave-shkolla?

Linda Gusia: Po, pjesa e shpijave-shkolla fillon realisht në janar të vitit 1992. Mu m'kujtohet shtatori i 1992-tës. Na kemi shku para Sami Frashërit si nxanësa të Sami Frashërit. Une e pata regjistru gjimnazin Sami Frashëri edhe kemi shku si me tentu me hy në shkollë. Edhe m'kujtohet dita e parë e shkollës të mesme, t'doket vetja që je rritë. Domethonë osht' nifar edhe ngazëllimi që je tu shku në shkollë të mesme. Po në të njejtën kohë tash po shkojmë te Sami Frashëri.

Sami Frashëri ka qenë poashtu shkolla ku nana jeme e ka kry shkollën. Edhe domethonë unë i kom ditë arsimtarët e Sami Frashërit prej nanës edhe prej kështu. Sami Frashëri ka qenë ni objekt t'cilin e kom pa veç qato ditë. M'doket si ka qenë java e parë kur kena provu me bo protesta edhe me hy. M'kujtohet herën e parë kur erdhën shumë polic edhe na nalën edhe e bonën nifar korridorit që qata, si me thonë, 20 nxanës serb me hy. Edhe na ishim me qindra jashtë, nxanës shqiptar, mos me hy.

Edhe m'kujtohet, domethonë, serbt tu hy e tu na përkeshë edhe tu na thonë fjalë të ndryshme. Edhe m'kujtohet ni- domethonë qajo ndjenja e poshtnimit edhe qajo ndjenja e fyerjes, qajo ndjenja ku domethonë nuk je leju me pasë qasje në shkollë, a po, ku kurgjo që ka qenë e zakonshme s'ka metë e zakonshme. T'90tat sidomos kanë qenë qashtu, ku çdo ditë diçka ka ndryshu n'të 90tat. Çdo ditë ka pasë naj dramë t're edhe kemi qenë përherë n'qitfar hijen edhe kërcënimin e luftës.

Sidomos në qato 2-3 vitet e para t'90tave kanë qenë shumë dinamike. Ka pasë shumë protesta. M'kujtohet, domethonë une edhe Mimoza ikshim nëpër protesta si 14 vjeçare, 15 vjeçare. M'kujtohet që prindrit e mi s'kanë qenë shumë të lumtun për faktin që shkojsha në protesta. Për mu ka qenë qajo nifar mënyre e- une kom pasë qef me shku në protesta si fmi. Për mu mu ka dokë protestat, edhe pse kanë qenë të dhunshme, sidomos protestat në fillim të 90tave kanë qenë të dhunshme.

M'kujtohet protestat e 92-tës këtu para fakultetit tash, ku na patën gjujtë kështu me ujë. Edhe ka qenë shumë dhimbshëm, se ka qenë ujë shumë i fuqishëm edhe shumë i vrullshëm. Edhe ka qenë shumë ftoft. Edhe une e kisha hallin ma të madh çka kanë me m'thonë prindrit kur shkoj n'shpi me tesha

t'lagta edhe qysh ka me u bo problem që prap kom shku në protestë pa leje. Po domethonë protesta-qajo fillimi i 90tave ka qenë jashtëzakonisht dinamik, i dhunshëm me shumë polici me...

Noa Nikqi: Protestat e orave policore a kanë qenë-

Linda Gusia: Po, orave policore domethonë menihere prej 89-tës na jemi rritë në nifar mënyre në orë policore. Edhe kur nuk ka qenë në fuqi ora policore, me dalë në mbramje nuk ka qenë opcion. Për shembull na kemi pasë-nejat i bojshim, kanë qenë do “Mesnata”, kanë qenë do kafiqa edhe në Breg t'Diellit. Na i bojshim nejat si me thonë n'12 t'ditës, n'1. Edhe i kena pasë- i lshojshim perdet t'zeza.

N'qat kohë u konë kështu si n'mode me ngu heavy metal. Une ngojsa heavy metal. Edhe shkojshim edhe bojshim kështu, kcejshim, e sillshim kryt ka njo dy orë ditën. Edhe shkojshim masnej n'shpi me hanger drekë me mamin e me babin, a po. Domethonë u konë qajo-na u nijshim. Shumë interesant qysh tash gjanat që jon komplet jo të zakonshme për neve u patën bo komplet të zakonshme, edhe ndoshta pse je i ri. M'doket që na si gjeneratë kemi qenë ma reziliente.

Kemi- a din-jemi mundu mos me mbetë mrapa n'kurgjo. M'kujtohet që ka qenë e rëndësishme për neve edhe me dalë, edhe me shku te njoni tjetri, edhe me bo, i thojshim me bo party, me bo zhurka, a po, edhe përkundër krejt rrethanave. Edhe mendoj që në vitet e 90ta ka pasë edhe ni- domethonë krejt qato struktura që kanë qenë rigjide edhe të kontrollit e kështu. Mendoj që prindve tonë ju kemi dhimtë ma shumë se zakonisht në vitet e 90ta, se diqysh e kanë pasë nifar ndjenje që jemi tu e jetu në nifar femijeriye, rinije e cila ska qene e zakonshme edhe- po edhe kane qene shume t'preokupum me mbijetese, edhe domethone jemi rrite...

Noa Niqki: Kjo ka qene faza qe kane hup punë shumë njerez-

Linda Gusia: Po, po. Prindt e mi...baba ka vazhdu. Baba ka punu n'Rilindje. Baba ka qenë redaktor teknik në Rilindje prej- po m'doket prej 87-tës. Ma herët ka punu në ni kompani tjetër “Plastika”. Ai osht disajner grafik. Nana ka punu pjesën ma t'madhe t'jetës së saj n'komunë si juriste. Nana e hup vendin e punës me- domethonë jon' protestat që i organizon sindikata e punëtorve në Kosovë. Edhe jon' protesta të cilat vetëm- domethonë m'kujtohet 3 shtatori në 1990 si nji ditë ku domethonë çdo gjë-osht' nifar ditë ku punëtorët nuk shkojnë n'punë edhe në përgjithësi krejt shqiptarët në nifar mënyre refuzojnë me marrë pjesë në jetën publike. Edhe osht' ni ditë ku gjithçka osht' shumë shkret.

M'kujtohet që kqyrshim prej dritareve edhe na si fmi kishim qef me dalë pak, po osht' dita ku domethonë osht' si nifar protestë e punëtorve, po osht' edhe si protestë gjithë-popullore për refuzimin me participu në qatfar regjimin e Millosheviçit edhe qato ndryshimet strukturore që i bon Millosheviçi. Edhe nana jeme shumë- domethonë mas qasaj e merr nji letër, si me thonë mas dy ditëve, ku shpallet si- domethonë për shkak të pjesëmarrjes në protesta edhe shpallet si tepricë teknologjike, ju thojshin ata.

Po domethonë t'90tat krejt Jugosllavia osht' në fillim të luftës, po edhe në krizë jashtëzakonisht të thellë ekonomike. Edhe për shembull në Kosovë një ndër politikave të para të Millosheviçit, krahas me qat mbylljen e shkollave edhe spitaleve, fillon edhe përjashtimi masiv i krejtve prej punës. K'tu nana metet pa punë. Për nanën ka qenë përjashtimi prej punës jashtëzakonisht i vështirë. Domethonë nana jeme ka qenë gjenerata e parë në familjen e saj që ka pasë të krym universitetin. Ka qenë dikush e cila ka punu jashtëzakonisht shumë, ka qenë nxanëse e mirë edhe për to ka qenë gjithmonë puna edhe pavarësia ekonomike si nifar emancipimi edhe sigurie edhe arritje.

Edhe m'kujtohet përjashtimi i saj prej punës e pat lanë krejt të humbun në kuptimin që domethonë u nijke si pa identitet, a po. Ajo ka punu ton jetën, ka punu prej moshës 21 vjeçare edhe tash në moshën ku mundet me kontribu ma së shumti ka met pa punë, a po. Edhe për to ka qenë jashtëzakonisht vështirë qajo periudhë. M'kujtohet që e shihshim kanihere tu qa në ballkon edhe thojke: "Mirë jom, njerëzt jon edhe ma keq se na, babi po punon." A po.

Ka qenë kohë e krizës t'madhe ekonomike, t'gjith rreth neve i kanë hup vendet e punës. Axha me grun e axhës n'Pejë. T'gjith, t'gjith që domethonë...m'kujtohet në familje- tezet, burrat e tezeve t'gjith. Domethonë për çdo ditë ish një telefonatë prej dikujt që e ka hup vendin e punës, që e kanë qitë prej punës. Gjith krejt sistemi i krejt qatyne njerëzve përreth teje përneher, si me thonë ma shumë se 90% e njerëzve jon pa punë.

Noa Niçki: A keni ndi ju hiç presion prej ksaj me u angazhu, a ka qenë hala shumë herët?

Linda Gusia: Me u angazhu ku?

Noa Niçki: Në punë, në çkado kështu...

Linda Gusia: Po, na...s'ka pasë edhe shumë vende pune. Qitu osht' edhe problemi. Domethonë s'ka pasë vende pune. Me faktin që gjithë qita njerëz jon përjashtu masovikisht prej punës, thjesht nuk ka pasë hapësira të punës. Mu m'kujtohet në moshën 16 vjeçare hera e parë që kom punu. Ni kushëri i jemi e ka pasë ni furrë në Pejë. E pat çelë qatëherë edhe ai pat metë pa punë.

Ka qenë deputet i Pejës edhe e ka pasë ni ide që- e ka pasë nifar ideje që "okej njerëzt gjithmonë kanë nevojë me ble bukë", edhe në kohë të krizave t'mëdhaja i vetmi sen që ka me funksionu jon' nevojat bazike. Edhe qato pak kursime që i ka pasë i pat ble do makineri në Turqi edhe i pat pru në Pejë. Edhe mu m'kujtohet që vitin e parë që u pat çelë, unë pata punu ton verën në furrë të bukës në Pejë. Edhe i pata ble vetit Martinkat e para, Starkat e para.

Kom qenë shumë krenare që n'atë kohë, kur ktu kanë qenë shumë të shtrejta- po kanë qenë edhe kështu simbole të nifar subkulture- që ka qenë të rëndësishme për neve. Edhe une kom qenë veçanërisht krenare që i kom ble me pare që i kom fitu tu punu n'furrë. Kshtuqë qajo ka qenë. Nuk kemi pasë- une s'kom pasë vende tjera t'punës përveç ksaj gjatë shkollës t'mesme. Domethonë qito

muajt kur kom fillu n'punë, domethonë se edhe s'kom pasë shumë mundësi. Domethonë krejt angazhimet tona kanë qenë vullnetare.

Edhe mu m'kujtohet n'95-tën, Valentina Saraçini që e kom pase poashtu kojshike, tu e dite që jom e interesume. Najhere i kemi kqyrë edhe fëmijët. Domethënë çka kemi bo, e krejt puna që e kemi bo ka qenë kryesisht vullnetare. Ne u gzojshim shumë kur na jepte dikush noj liber ose na shpërblejke qishtu diçka. Më kujtohet Valentina me pat tregu që Gjeraçina Buçinca Vula edhe Afërdita Saraçini janë tu e bo njëfarë kursi për gratë, për vajzat që janë të interesume në gazetari.

Unë në atë kohë kam qenë e interesume në gazetari, në te 90-tat. Per shkak që kom pasë qejf me lexu, po edhe kam pasë nevojë me i përcjellë ngjarjet me lexu, dhe kam qenë e interesume në gazetari. Edhe, kur më ka tregu Valentina, kemi shku te Gjeri ne shpi që ka qenë në lagje në Dardani, edhe bashkë me Mimosën. Edhe për mu ka qenë kështu... ndoshta nje nder përvojat ma formative në jetën teme. Qajo dhoma e pritjes, edhe kuzhina e Gjerit, edhe jemi konë plot, kur e kom taku Eli Krasniqin, kur e kom taku Garentina Krajën, Jeta Xharrën edhe plot çika tjera, te mahalles e çikat tjera të Prishtinës, të cilat kanë qenë të interesume me mësu me bo diçka.

Te Gjeri dhe te Afërdita shkojshim qishtu nëpër shtëpi. Unë e kam pak kujtesen e keqe, nuk po e di sa here ne jave, po mu mu duke që goxha shpesh shkojshim, njo dy here a tri ne jave. Vishin njerëz të ndryshëm dhe na mbanin kurse të ndryshme. Për shembull kurse për fotografi, kurse për qysh me përdorë kamerën, kurse qysh me shkru ni lajm, apo mandej me ane te Media Project-it. Organizata e Gjerit e ka pase emrin Media Project, mandej përmes Media Project-it kemi qenë te ekspozume edhe me organizata tjera të grave.

M'kujtohet ne 96-ten pata shku për herë të parë në Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, në qendrën e Sevdije Ahmetit dhe Vjosa Dobrunës. Sevdija, Vjosa, të gjitha këto gra për mu kanë qenë gra jashtëzakonisht shume inspiruese. Më kujtohet ne qat podrumin e qendres, ka qenë hera e parë që pas një kohe të gjatë, me kujtohet mandej që e kom kuptu që ka qene Anne Snitow edhe Lepa Mladenovic.

Anne ka qenë një feministe e famshme amerikane që vike shpesh në rajonin ne ballkan, edhe ka mbajt kurse per peaceful resistant. Nuk mbaj mend shumë prej çka është thonë ne ato kurse, por e mbaj mend njëfarë energjie të re edhe ndryshe që ka qene ne qatfar podrumi. Më kujtohet jon kon do lojëra që për neve kanë qenë të çuditshme. Domethënë qishtu edhe mu me pat qellu me e pase secret friend and protector Vjosa Dobrunen. Edhe Vjosa mi pat jep do kartolina. Spo di, ka qenë njëfarë qeshtje e mentorshipit te këtyre grave edhe një lidhje që u kriju, që e ka ushqy edhe qatë ndjenjën me bo dicka.

Ni shtytje shumë e madhe për mu ka qenë qajo ndjenja për me u angazhu dhe me bo diçka. Domethone Media Project-i ka qenë njëfarë hapësire ku me vajza tjera bojshim shkrime të ndryshme. Kemi pas njëfarë reviste "Ritrea". Pata dale ne faqe t'parë të revistës. Edhe per mu ka qene mandej nifar pak edhe turpi se...

Noa Nikqi: Per cka keni shkru?

Linda Gusia: Kemi shkru për çështje të ndryshme ditore, me t'tregu të drejtën. Unë e kam edhe e kam pase edhe këtë përvojën e Feniksit në shkollë të mesme, në '94ten, me profesorin Nazim Lleshi, profesori Nazim Lleshi, ka qene një ndër, kemi pasë shumë profesorë inspirues në Sami Frashër.

Po, Nazimi ka qenë dikush që në njëfarë mënyre e ka kultivu edhe qat dëshirën tonë me lexu, po edhe dëshirën tonë me eksploru e me bo- e me zbulu gjana, edhe Nazimi për shembull, Nazimi ka pas shumë njohuri për psikologji, mu në atë kohë më pëlqejke shume psikologjia, mu duke si një farë mënyre e mirë për me e spjegu rrethanat shoqërore, me e spjegu çka po ndodhë. Edhe me Mimosën, me Arta Dobroshin, me Dardan Selmanin, me Artin Lahun, me Bersand Dishen patëm fillu Feniksin. Emine Valën, *of course*. Edhe me Eminen e patëm fillu.

Ka qenë një dhomë ne Sami Frashër, shumë e vogël, për me mujt me u shfrytëzu për çkado qoftë, domethonë. Ka qene pak si magazinë dhe nuk e di si dikush e ka do nu një kompjuter. Bersandi ka qenë ai prej krejtë neve që na ditë me kompjutera kështu, dhe ne veç kemi fillum mu mbledhë qat'herë. Profesori Nazim na lekje me përdorë qat salle, e patëm bo redaksinë, e patëm bo kështu edhe rishim, rishim mbas mësimit, rishim tonë kohën në shkollë. Edhe e patëm nisë Feniksin.

Në gazetën e shkollës, edhe në gazetën e shkollës e bëhim krejt; kemi pasë liri të plotë, se profesori Nazim ka qenë qasi lloj profesori inspirues, që veç na lonë me përzgjedhë çka dojme me shtu çka dojme dhe kryesisht ka qenë kështu. Na kqyrëshim në atë kohë shumë MTV. Edhe kqyrshim emisione të ndryshme.

E këqijshim Beverly Hills, paramendo çfarë disasociacioni kshtu mes realitetit, ku ishim na edhe qa kqyrëshim na në televizor- tash ne e kishim një farë ideje që dojna me e bo librin vjetor, dojna me e bo gazetën e shkollës, dojna me fol për STD, dojna me fol për kush na pëlqen ma shumë, dojna me fol për dating, dojna me fol për çështje që s'janë politike; ka qe domethënë, që kanë qenë si argëtuese, qajo ka qenë në njëfarë mënyre si politika e Feniksit, por natyrisht që kemi pasë gjithmonë edhe diçka- më kujtohet Eminja- pat mbri me folë me Ismail Kadarenë dhe kena, domethonë, ka qenë kështu prej atyre ngjarjeve ma të jashtëzakonshme. Se Eminja na tregojke tash krejtë ne detaje, na natyrisht, të gjithë e kishim lexu Ismail Kadarenë.

E kishim kështu nifar asi adhurimi për shkrimet e Ismail Kadaresë, kshtuqë per neve si ngjarje e madhe, njëfarë kombinimi interesant mes gjërave të ndryshme kur e kqyri, t'90tat. Mandej me Mimosën patëm menjëherë në fillim diçka si 93ten- kemi pasë qef me bo një intervistë me Anton Qetën, me Mimosën me- Kemi shku nja tri-katër veta te Anton Qetta m'kujtohet, si cika te shkollës t'mesme. Edhe habitna, dhe sot me modestinë dhe zemërgjanësinë se kujtohet që s'ka qenë shumë mirë me shnet- me shnet kur na pat taku edhe në një dhomë, na do cika të vogla, që s'dijshim as çka po dojme me pytë, qysh me folë.

Noa Nikqi: Qysh keni mbri me e kontaktu?

Linda Gusia: Po, domethonë Prishtina e vogël. Kemi... nuk po më kujtohet saktësisht, a na ka ndihmu profesori Nazim, nuk po më kujtohet, po domethënë, m'kujtohet qajo dhoma e tij e pritjes, edhe dashamirësia e tij, edhe sa shumë kohë pat marrë me folë me neve, edhe sa shumë kohë ka marrë me na bo pyetje, po ashtu rreth çka jemi tu bo, dhe sa shumë ka qenë i gëzum që, përkundër rrethanave na ishin kështu shumë entuziastë, e kishim bo gazetën, i mbledhëshim paret vetë për gazetë, shtypshim vetë.

Domethonë, krejt procesi i shtypjes së gazetës të cilën e jepshin pa pare, ka qenë kështu shumë vullnetar; po domethonë ka qenë pak a shumë- shkolla e mesme ka qenë kështu t'u marrë me Feniksin e t'u marrë me qësi sene; mandej fundi i shkollës t'mesme ka qenë Media Projekti si pjesë e rëndësishme formative e qasaj- 96ta fillon- dhe u kry- mendoj që një diçka që ka qenë një kthesë tjetër që e mbaj në mend si një ngjarje e cila m'kujtohet si një ngjarje që e pat ndryshu pak- m'kujtohet fundi i Daytonit: komentet, diskutimet në shtëpi.

Për neve ka qenë shumë zhgënjyese që përfundoi Day toni, m'kujtohet që me Mimosën dhe ulëshim hymje dhe folshim: çka domethënë tash Dejtoni? Çka domethënë fakti që na kanë harru ne Dayton, çka domethënë fakti që s'na kanë përmendë, e çka domethënë për ne në përgjithësi- më kujtohet që ka qenë kështu si një far periudhe, ku sidomos na që ishim ma t'ri e kishim një farë revolte. Më kujtohet shpesh u shtyshim me babin, për idetë se cila është, a po, që ndoshta duhet me pas na një farë rezistence më aktive.

M'kujtohet që n'qatë kohë njiheshim që rezistenca paqësore nuk- sidomos mas Daytonit që rezistenca paqësore nuk po funksionon, po edhe qato poshtnime të përditshme, a po, pershembull dilshim na në Kurriz me shëtit, dhe më kujtohet vec kur na mbyllshin të dy dyert e kurrizit, janë kanë të dyrë të hekurta. Veç kur i nijshim ato dyert tu u mbyllë, e dishim që i ka hi Racia edhe tash, a po, ka me pasë malltretime, a po, "ku e ki letërnjoftimin?". A din, sidomos djemtë, mendoj qe ka qenë shumë vështirë për djemtë, në atë kohë.

Për çikat, domethënë, zakonisht nuk ka qenë kështu naj farë ballafaqimi fizik, po më kujtohet për djem gjithmonë ka qenë kështu si, domethonë Racitë, sa herë që ishim dika, sa herë ishim të mbledhun , ndodhke diçka- m'kujtohet, m'u kthy mbrapa tash, për shembull, gjysëm matura kur e patëm kry shkollën fillore ka qenë qaq keq kur e kemi kry na shkollën fillore në 92tën, sa s'kena bo as mbramje të maturës; veç u patëm mbledhë te një shok n'shtëpi. Edhe më kujtohet që kështu u patëm mbledhë veç si dy-tri klasa bashkë dhe na patë ardhë policia se dikush në hymje e ka thirrë policinë që po bojmë zhurmë.

Domethonë ka qenë vazhdimisht qiky "po vijnë t'zit", thojshim a din "po vijnë t'zit", dhe gjith o' konë qikjo "okej hajde, tash na prishin krejt" edhe njëfarë tensioni i vazhdueshëm, Inifar ikje prej tyne, ashtu po nuk e di; nuk e- domethënë e mbaj në mend qat reziliencën e qasaj kohë e majnë në qatë nevojën për me dëshmu publikisht që sjemi tu u frigu.

Noa Nikqi: Në çfarë mënyre e keni shprehë ma vonë këtë rezistencë?

Linda Gusia: Po qe një shembull të thjeshtë: për shembull, në 96tën, kur pat dalë “Braveheart” në kinema, edhe pse na jena konë shumë t’varfër, edhe me shku në kinema qenë shumë në lluks. E shkojshim me Mimosën- unë e Mimoza kemi pasë qef’ me kqyrë shumë filma, vazhdimisht “rentiratshim” filma.

Po, kur pa dalë “Braveheart” në kinema këtu në qytet te Qafa, shkojshim me kqyrë “Braveheartin” pak ma shumë, se ka qenë njëfarë momenti te “Bravehearti” ku thojke “I would rather die here in this battle today...” se a din, “die in my bed as an old man.”- “die for freedom-” qisi, nuk po më kujtohet teksti po osht’ njëfarë teksti, kështu patriotik, patetik- edhe na tash në gjatë moment-a e din, o’ konë kështu ma shumë si me- na pëlqeje reagimi i serbve se u frigojshin edhe na bojshim... a din, ashtu bërtitshim, a dikush bojke kështu... u entuziazmojshim, se aty krejt’ terr dhe mujshim edhe me thanë “Kosova Republikë” e qisi sene, edhe m’kujtohet që sërbët u tutshin prej ati reagimi edhe- tonë në përgjithësi.

Po u kon e njëfarë reagimi që ta jepke, m’kujtohet njejtë edhe Rrusta e ka pasë një kangë, diçka tu thanë “Don’t fuck with Albanians”, edhe domethonë n’secilën party në fund diçka, e lshojshim qata “Dont fuck with Albanians”, ja Rrusta e knojke qata “Don’t fuck with Albanians”, Petrit Çarkaxhiu.

E domethonë o’ konë qajo njëfarë revolte manej- për shembull unë e Mimoza ckyjshim qisi postera e rrugës të Milosheviçit tu hecë, a din. Me qësi subversione të vogla, se ka qenë njëfarë idhnimi; ka qenë një farë idhimi dhe ka qenë një farë ideje se si gjeneratë na duhemi me bo diçka. Gjenerata para neve, për shembull, ikshin, shkojshin dika, a po. Domethonë ka qenë, kushdo që e kryeje shkollën e mesme- sepse mandej edhe na e kryjtem krejtë shkollën e mesme në shtëpi-shkolla. Përshembull, gjenerata jeme ka qenë gjenerata e parë: 92-96, qe e ka kry krejtë shkollën në shtëpi-shkolla.

M’kujtohet kur në 96tën kur patëm shku me festu. N’Jugoviç në një kafë diçka tu na çu kështu si ndamas me autobusa me festu mbramjen e maturës. M’kujtohet që o’ konë diqtsh qe na jena qajo gjeneratë që prej fillimit deri në fund kemi qenë në shtëpi-shkolla, tash po vazhdojmë fakultet në shtëpi-shkolla, po në të njëjtën kohë ka qenë qajo gjeneratë që plot prej neve nuk e kanë pasë si gjëratat ma herët, që domethënë e kryjshin shkollën e mesme dhe kqyrshin me dalë. Për neve edhe dalja në qatë kohë o’ konë gati si e pamundur, domethonë ai izolimi total. Na s’kena pasë as pasaportë në atë kohë...

Noa Nikqi: E qysh është zhvillu ky sens i rezistencës me fillimin e luftës?

Linda Gusia: Unë me- 96ta ka qenë shumë qashtu- 96ta si dalin... del UÇK-ja, osht’ vrasja e Armend Daci, m’kujtohet si një ngjarje tjetër shumë dramatike se- pramendo Armend Daci u pat vra t’u nejtë, domethënë t’u ardh n’shtëpi prej kojshisë me snajper rrugës- diçka që, për shembull, për neve ka qenë shumë traumatike, sepse na ishim dikush që i kishim pa krejt këto vrasjet me snajpera që i bojshin në Bosnjë, a po.

Në Sarajevë- Sarajeva ka pasë atëfar rrugën e snajperistëve dhe që ky personi, kojëshia që e ka vra Armend Dacin, me siguri ka qenë qështu dikush i kthymë prej luftës, najfarë snajperisi që ka ardhë prej Bosnjës. E tash përfundoi lufta në Bosnjë dhe ka qenë poashtu edhe qajo ndjenja që na ka ardhë rendi, se shumë qata ushtarë serbë që kishin shku me luftu në Bosnjë, plot prej tyne tash ishin këtu, forcat e Arkanit; u kthynë këtu... a po, presioni edhe tensioni ish ma i madh në 96tën, në 97tën.

Po, në të njëjtën kohë edhe fillon qajo rezistenca, po edhe fillon me eskalu dhuna. Në njifarë mënyre, kur e mendoj në retrospektivë, o' konë shumë: na e kemi pritë gjatë krejt t'90tave qat eskalimin edhe dhunën edhe luftën- a po, domethënë një farë shprese e vogël që çështja e Kosovës po zgjidhet në mënyrë paqësore ka qenë shumë optimiste, me t'tregu t'drejtën. Lufta për shumicën e neve që kemi qenë t'ri e fëmijë në qatë kohë, ka qenë e paevitueshme.

Kur fillojnë- domethonë 97ta është qashtu- po ashtu viti jem i parë në shkollë, në fakultet: në fakultet jom regjistru në sociologji dhe filozofi. Natyrisht, osht' dashtë me regjistru edhe anglishten se... për nanën teme ka qenë shumë e rëndësishme me qenë e pavarur ekonomkisht, edhe me sociologji dhe filozofi nuk ka karrierë. A nuk ka, a po, varëshmëri. Ma bojke "Ku don ti? Nuk mundësh kurrqjo me i ble vetit.

Duhesh me regjistru edhe anglishten"- edhe pse për prind e mi kjo ka qenë zhgënjim total, se une kom' qenë nxanëse e mirë. Ka qenë, për ta pritja ka qenë unë me shku në mjekësi, a në farmaci, a në një prej fakulteteve ma prestigjioze; kështu që kur e kam zgjedhë sociologjinë, filozofinë, për ta ka qenë zhgënjimi total.

Marksizëm-Leninizëm, m'thojshin po shkon me mësu edhe anglishtja ka qenë masanej: okej, për me mujt me ble njëfarë paqeje, kom shku edhe një vjet në anglisht, mandej u lon anglishten e kom shku- po domethënë shumë shpejt mas vitit të parë, domethonë kom qenë student dhe përnime veç një vjet, menjëherë vitin e dytë, domethonë se mesin e katërt fillon lufta. Fillojnë masakrat në Drenicë. Edhe m'kujtohet Jeta Xharra më ka thirrë me telefon.

Sa ndodhi, domethonë, Masakra e Jasharajve, edhe m'ka pyte "A tutësh me shku deri në Drenicë? Janë do gazetarë këtu. Hajde" o' konë njifar Park Hotel. "Hajde menjëherë qitash!" Edhe pata shku edhe domethonë kom' thonë "Po more, qysh, une e stutna". "Osht' rrezik- a e din- mos m'thuj mandej!" "Po osht' rrezik..."

Edhe m'kujtohet që u konë kështu si njifarë, "Po po, gjithqysh." Edhe se pata pytë kërrkon, as prindëve s'ju pata tregu as kurrqjo , se e disha që s'më lojn' dhe veç kam thonë "Kam diçka punë." Se veç u patën mësu me angazhime. Pata shku me një gazetar japonez, edhe jena nisë për Drenicë. Edhe s'ka pas shansë me- krejtë rrugët kanë qenë bllokume- mu m'kujtohet i kemi ra ka Vushtrria, edhe mandej me traktorra kemi shku...kemi zhdrypë poshtë, ne Prekaz.

Domethonë kështu ka qenë dita jem e parë e punës. Po n'të njëjtën kohë, mu nuk m'ka ra me shku nëpër fshatra në Kosovë, kom shku në Pejë, Mitrovicë, në Mitrovicë e kom pas hallen, në Pejë gjyshen,

krejt tjerët kane qenë ne Prishtinë domethonë nuk m'ka ra fort me udhëtu në Kosovë në përgjithësi. Edhe m'kujtohet qashtu na kanë afru me traktora. Kanë qenë shumë kështu.

Na shkojshim ne qato fshatra, i pyetëshim a mujmë me vazhdu, e patëm lonë kerrin, e ata kanë qenë kështu, qata fshatarët që na kanë çu kanë qene pjesëtarë të UÇK-së, mandej e pata marrë vesh, te veshur civil, edhe ata dojshin gjithqysh me çu sa më shumë gazetarë për me e pa çka po ndodh. Dhe na patën çu me traktor deri diku. Mandej na patën vazhdu në Prekaz të epërm, kogja ma nalt na paten lonë. Mandej na patëm ece prej Prekazit te epërm në Prekaz te poshtëm edhe m'kujtohet kur kom mb'rri ne Prekaz, ka pasë qaq shumë pluma sa nuk mujshim me ecë rreth shtëpisë së Jasharajve.

Disa shtëpia më nalt e patëm gjetë trupin e nje gruaje plake, mas deres, që e kanë vra, e që po duket kanë harru me marrë. Domethënë kur kemi mbrri na, ajo ka qenë trupi i vetëm, dhe më kujtohet për mu ka qenë personi i parë që e kam pa të vdekun realisht. Se atëherë edhe më pat vdekë veç gjyshi po as gjyshin se kom pa kur ka vdekë. Edhe mandej patëm zhdrypë poshtë te shtëpia e Jasharajve, edhe shtëpia ka qene po thom- për mu ka qenë kështu, më vjen shumë keq që muzeu sot, i Jasharajve se ka kapë qate elementin, qat brutalitetin e qasaj dite dhe qatyne ditëve, edhe që nuk e ka kapë qat përditshmërinë.

Për mu çka më ka lonë ma së shumti përshtypje kur kom hy në shpi te Jasharajve ka qenë që ka qenë shumë nifarë, do sahana të hekurit, me buke e përshesh në to. A din, kanë qenë do çizme të llastikut te fëmijëve. Më kujtohet që ka qenë një farë gjygyimi me shumë ngjyra dhe që ka qenë krejt i rrotullum. Domethënë ka qenë që qaj vendi ku është mshefe Besarta, i vetmi person që i ka mbijetu masakres.

Po domethonë ejt shpia ka qenë me pluma, me gjak. Ka qenë shtëpi banimi, dhe për mu është dështim edhe prej anës tonë që s'kemi mbërrin me përçu te gjeneratat e reja, sa makabre dhe sa e dhunshme kanë qenë qato ditë edhe sulmi i Jasharajve. Sepse, mënyra qysh tregohet sot, unë kam shku edhe mas luftës te Jasharajt dhe për mu ka qenë kështu njëfar, si dikush që ka qenë aty ato ditë, ka qenë njëfarë shkëputje. S'mu ka dokë që e ka kapë qat atmosferën e shtëpisë. Sepse kjo është shumë e rëndësishme më përmend, Adem Jashari e Hamëz Jashari dhe familja Jashari kanë rezistu, po kanë rezistu ne shtëpi të tyne.

Edhe shumica e njerëzve që kanë vdekë qat dite kanë qenë gra dhe fëmijë të pafajshëm, e kjo është shumë e rëndësishme. Kjo është diçka që nuk kemi mbërrin me percu. Se e kemi pasë shumë të rëndësishme me tregu qat ditë si ditë e kryengritjes e rezistencës, që është, po ka qenë kryengritje dhe rezistencë e njerëzve të pafajshëm, qe kanë ardhë me i vra te shpia e vetë, edhe në mënyrë ma brutale i kanë vra. Ma vonë qatë ditë kemi shku ma poshtë te xhamia, kanë qenë krejt trupat aty.

Edhe, po më kujtohet që atë ditë domethënë, me krejt qata trupa që i patën pru aty, mandej domethënë qato ditë kanë qenë varrime e qvarrime. Edhe qato kanë qenë ditët e para të mia në terren, na thojshin fixer-a, përkthysë. Edhe kanë qenë ditë qe mandej prej qasaj dite të parë ne Prekaz, mo nuk jam ndalë. Pastaj kom qene cdo dite ne teren.

Pak më vonë, qat fund t'verës, pata fillu me punu me Washington Post-in, me Jeff Smith dhe me Peter-in të Washington Post-it, kryesisht këta dy kanë qenë në Kosovë, ka pasë mandej edhe korrespondentë tjerë që kanë ardhë. Po kryesisht kam qenë me Washington Post-in. Natyrisht me njerëz të ndryshëm, disa njerëz që kemi fillu me punu prej fillimit, kemi qenë kështu si vazhdimisht në terren.

Noa Nikqi: Çka ju ka ra konkretisht me bo në terren?

Linda Gusia: Po na për shembull gjithmonë e kemi nisë ditën tu i lexu krejt gazetatat. Jemi qu herët i kemi ble krejt gazetatat shqip e serbisht dhe më kujtohet që ka qenë si ritual me shku në Morenë. Morena ka qenë kafja e shokëve të mi, Lorikut Qosjes edhe Donat Qosjës, edhe ka qenë afër shtëpisë teme dhe unë zakonisht i kom ble krejt gazetatat, jom ulë n'Morene, ka ardhë Jeffi a Peter, me cilin do që kom qenë tu punu, edhe kemi shku nëpër krejt gazetatat, edhe kemi kqyre çka është tu ndodhë. Unë i kam lexu titujt, edhe çka po raportohet, dhe mandej nëse ka qenë ndonjë artikull interesant, e kom lexu dhe e kom përkthi qaty për qaty, tu pi kafe ne Morenë.

Mandej ka pasë ditë tjera, nëse ka pasë ngjarje, kemi shku drejt te ngjarja. Nëse kane pas Jeffi a Peter naj informatë se çka ka ndodhë ose nese dicka ka ndodhe qat jave, e kemi përcjellë. Këto ditet kanë qenë ditë kur nuk ka pasë ndonjë masakër apo ngjarje dramatike. Ditë tjera veç kemi hyp në kerr dhe kemi shku në, kryesisht kemi shku në Drenicë.

Drenica ka qenë zona me ma së shumti luftime, po edhe në Drenicë ushtarët kanë qenë ma miqësorë se për shembull në Dukagjin, me gazetarë, edhe ma miqësorë edhe me mu. Domethonë shumë herët u pata njoftu- më njëfishin se ishim disa që shkojshin vazhdimisht në terren. Une, Garentina Kraja, Nebi Qena, Ylber Bajraktari, Fisnik Abrashi, një kohe kemi qenë një farë grupi. Ata kanë qenë gjithë në Kohë Ditore. Unë s'kam qenë në Kohë Ditore. Mimoza, njëjtë shoqja jeme. Domethënë kemi qenë një far grupi ma i vogël që kemi qenë në terren për çdo ditë.

Edhe qashtu, kanihere veç kemi lëvizë nëpër Kosovë me kerr, e mbaj mend që vazhdimisht ton ditën kemi shku, kemi kqyrë me folë me sa ma shumë njerëz, sidomos kemi përcjellë për shembull nëse ka pas një ngjarje, nëse ka pas një masakër dika. Kemi shku zakonisht disa ditë me rend në të njëjtin vend. Roli jem ka qenë po ashtu me i aranzhu intervistat. Me i thirrë njerëzt në telefon. Ka qenë vështirë kanjëherë me i thirr në telefon, me ju ra në fije ku janë dhe ku kemi me shku për me i folë me, kryesisht me pjesetare të UÇK-së në qatë kohë. Shumë shpesh kemi folë, ideja ka qenë që shkojshim në vend dhe mandej intervistojshim njerëz.

Noa Nikqi: Prej qëllimeve që i keni pasë, sa ka qenë e rendesishme prej juve me tërheq vëmendjen e internacionalëve?

Linda Gusia: Për neve... e para per shembull kur kemi dalë prej Prishtinës gjithmonë jon' konë shumë checkpoint-e të policisë, ky i Komoranit u kon. Gjithe jon konë do njerez shumë të poshtër në

Komorani, edhe policë shumë të poshtër dhe shumë shpesh kemi pas probleme. Shumë shpesh ka pas kështu me ja thy pasqyrën ktyne, jo me bërtitë, me na pytë ku po shkojmë, çka po bojmë.

Mendoj që shumë shpesh nuk na kanë marrë seriozisht dhe kjo ka qenë një bonus, sepse unë shumë shpesh, unë jom kon qathere njëzet e një vjeç. Edhe kur e sheh një çikë të vogël nëpër terren, sja mushshim synin që na dimë me interpretu çka po ndodh rreth neve, edhe që na dimë najsen. Kryesisht u dukshim që na veç jemi qaty me qata gazetarë. Po ashtu në një farë mënyre fakti që kemi qenë vajza ka qenë për herë të parë ne shoqni tonë benefit, qajo mos me të marrë shumë seriozisht.

Ne kontekstin patriarkal kur të rritesh në Kosovë, në njëfar mënyre negocion me qito avantazhet, kur dikush nuk të merr seriozisht, po është ma lehtë masanej me manovru. Na patëm, sa ma shumë që kemi qenë në terren, qaq ma shumë ka qenë qaj roli me, për neve ka qenë shumë e rëndësishme me e tregu çka po ndodh. Për neve ka qenë një prej mënyrave kryesore me, ka qene qajo nevoja me e zotnu narracionin rreth asaj se çka po ndodh në Kosovë, me tregu se çka po ndodh përmes gazetarëve, me i internacionalizu ngjarjet në Kosovë, me e internacionalizu qat brutalitetin, qat dhunën, qat përvojën tonë, për neve ka qenë kështu si mision.

Domethonë më kujtohet që ka qenë e pakta që kemi mujt me bo, jemi ndi që natyrisht unë di me fol anglisht dhe ka qenë privilegj me pasë qat mundësinë me interpretu edhe “to bear witness”, po edhe me qenë dëshmitare e qatyre ngjarjeve. Po sidomos për neve ka qenë shumë e rëndësishme që qajo dëshmi me dalë jashtë Kosovës, që me u internacionalizu çështja e Kosovës. Ideja e intervenimit në atë kohë ka qenë shumë si ëndërr. Me tregu të drejtën unë kurre s’kam besu që ka me pasë intervenim të NATO-s.

Po ka qenë një farë nevoje e një lloj intervenimi ndërkombëtar që na kemi qenë shumë të fokusum gjatë gjithë 90-tave. Levizja paqësore, rezistenca paqësore, çdo gjë qa kemi bo në t’90-tat e ka pasë edhe një element shumë të rëndësishëm të ndërkombëtarizmit, sepse na kemi qenë thellësisht t’bindun që çka po ndodh në Kosovë është thyerje elementare e të drejtave të njeriut, edhe kemi konsideru që sa ma shumë që dihët dhe sa ma shumë njerëz që e kuptojnë dhunën sistematike që ka ndodhë në Kosovë, qaq ma shumë na rriten mundësitë e intervenimit ndërkombëtar.

Mendoj që për neve ka qenë kështu një shtytësi. Na kemi qenë në një farë negociator. Për neve ka qenë po ashtu shumë interesant me pa, shumë shpesh kemi qenë dëshmitarë kur editorët e Washington Post-it, thirrshin edhe na thojshin “jo, spe dojme”. E shihshim qat procesin e negocimit të cili artikull bon, cili artikull s’bon, cka është histori e re.

Më kujtohet menjëherë mas luftës, krejt verën e 99tës e patëm kalu ne nifar rikonstruktimi te masakrave. Domethonë çdo ditë, çdo ditë, çdo ditë, kah dy-trembëdhjetë orë në ditë kemi qenë në terren. Edhe më kujtohet që diku në fund të gushtit editorët thirren edhe ne interfon te kerrit e nijsha “jemi lodh me masakra, gjeni ni Romeo and Juliet story. U kry lufta tash, edhe boll me masakra”. Edhe m’kujtohet qe ka qenë kështu si “woah”, nje far zhgënjimi.

Noa Nikqi: Sa e keni pasë ju në dorë si përkthyesë këtë pjesën e interpretimit?

Linda Gusia: Pikërisht na ishim interlocutors. Na ishim në mes dy palëve. Na tu nejt ton ditën me gazetarë, e kuptojshim edhe ishim ma afër interpretimeve, diskutimeve edhe vështrimeve te tyne. Ne ishim shumë afër me e pa se cila osht qajo lenta, na ishim tash shumë të vetdijshem për qat kendveshtrimin e tyne. Na tash rrishim me ta ton ditën. Na ishim në terren, ishim miq me ta edhe vazhdimisht diskutojshim rreth çështjeve të ndryshme, interpretime të ndryshme të rrethanave.

Më kujtohet shumë shpesh kur ishim në nifar intervistë me Jakup Krasniqin dhe i thojshim: “mos e thuj qishtu, ma mirë është me e thonë kështu”, a po ju jepshpim ka pak informata, për shembull se cili osht interpretimi i tyne a cka po thojnë këta, a po? Ka qene nifar si ideje se si poashtu, per shembull shumë cka ka qenë shumë vështirë me përkthi.

Më kujtohet Fehmi Lladrovci... Fehmi Lladrovci ka qenë i famshëm që s’jep intervista. Me Fehmi Lladrovcin e Xheve Lladrovcin, i shihshim, i shihsha unë në terren shpesh, para bombardimit te NATO-s po flas. Edhe “Gusia” m’tha, “hajde ktu!”. M’murr një herë n’pytje për qëndrimet e mia politike për atë kohe. Ka qenë një person shumë karizmatik edhe mirëpo kur folke, vazhdimisht thojke, “Evropa lavire” edhe për me ta ilustru këtë editimin që bojshim në përkthim. Tash për mu ish kështu shumë gazep me përkthi “Evropa Lavire” dhe tash pa kontekst edhe qaty për qaty, une thash “Old Europe”. Edhe tash, çdo dy minuta thojsha: “Old Europe”. Edhe tash, kur u kry intervista, ma bonen pse po thu, “Old Europe?”

Edhe une thash tash është qikjo ideja që Evropa na ka tradhtu disa herë edhe që ekziston njëfarë mosbesimi në politikat evropiane dhe ky në fakt tha “whore Europe, Europe the old whore”. E unë e thashë, e thashë veç “old” e kështu. Po ka pasë për shembull edhe momente kur do gjana që menojshim që, a e din që është pak, domethonë e kemi pasë qat idenë e negocimit, çka duhet me u pa, çka duhet me u thonë, qysh duhet me e interpretu diçka a po, për shembull pse në noj vend burrat spo i lojnë gratë me folë shumë?

Domethanë, ka qenë- ka pasë kështu shumë interpretim kulturor të realitetit tonë, na kemi qenë po ashtu edhe jo shumë mirë të përgatitun për qat lloj interpretimi. Tash kur e kqyri, tash kjo ka qenë në dorën e disa njëzet vjeçareve, me vendose a po dojne me thonë Evropa lavire, apo me thonë “Old Europe”. Në njëfarë mënyre ka qenë ky procesi i negocimit, të asaj se çka po përkthehet, qysh po përkthehet edhe ka pasë kështu për shembull shumë herë ku jemi shty e jemi përta për bindje politike n’kerr, po ka qenë njëfarë edhe barrë shumë e madhe që kemi pasë na si njëzet vjeçarë.

Barrë e madhe e reprezentimit edhe barrë e madhe e mosdeformimit të asaj se çka po ndodh. Për mu kjo ka qenë shumë e rëndësishme. Unë pata vendosë qatëherë që nuk du mu bo gazetare, sepse mu duke ashtu shumë jo fer... Sidomos kur kemi qenë refugjatë. Qajo pjesa kur kemi qenë refugjatë dhe kur na bibe me përkthi histori të cilat kanë qenë shumë tragjike, shumë te ronda, për mu ka qenë, domethonë, që na shkojshim e perkthejshim edhe unë u kthejsa në shtëpi dhe flejsa në dhome të nxehte n’Dardani.

Per mu ka qene qajo ndjenja shumë e madhe e fajit, përkundër faktit që, po, jemi tu bo diçka. Ka qenë një ndjenjë e fajit, edhe një ndjenjë e madhe e privilegjit, po edhe një ndjenjë e... për shembull, shumë prej artikujve, për shembull e kryshim shpejt, i merrëshim t'dhanat kryesore. Kjo ka qenë edhe e mira, kur kam punu kanjeherë me BBC e kanjeherë me televizione tjera, televizionet s'më pelqejshin hiç, se televizionet ishin shumë performative. Për shembull te televizioni ish shumë me rendesi me pa zjarrin, me e kapë kështu, domethënë ish shumë e rëndësishme pamja.

E me gazetarë hulumtues, domethënë rrijshim pak më gjatë në hulumtim, po prapë ishte diqysh "tregona" dhe na ishim aty që njerëzit me na tregu ditën më të keqe të jetës tyre, me na tregu ngjarjen më traumatike të jetës tyre, dhe na iu thoshim "falemderit shumë ditën e mirë" e lejsim shumë, shpesh e lejsim, kështu m'kujtohet sa here kështu na "duhet me shku" dhe fillojshin bombardimet e fillojshin sulmet edhe na veç shkojshim. E për mu për shembull qajo m'kujtohet gjithmonë si prej seneve ma të sikletshme në punën që e kom bo si përkthyes. Edhe qaty, mu duke qikjo mos me mbërri me shku deri në fund, mos me mberri me e elaboru deri në fund një çështje, m'u ka dokë që është, qaty pata vendos që jo definitivisht, s'du me qenë gazetare. Nuk është për mu, për mu është shumë me rendesi me shkru më gjatë, më thellë, me pasë kohe. Koha ka qenë shumë e rëndësishme.

S'po di, domethonë, qikjo të qenunit përkthysë ka qenë po ashtu jashtëzakonisht traumatike. Unë për shembull nuk mbaj mend shumë ngjarje. Ja i kam t'këputuna kështu si.. I kom' shumë të reduktume. Krejt qaj viti i parë mas luftës ka qenë shumë traumatik në përgjithësi. Edhe në vitin e parë të luftës domethene, gjatë luftës, para luftës, ka qenë një farë rezistence ma e madhe.

Mas luftës, kur përfundoi lufta, diqysh qajo periudha e pasluftes ka qenë shumë, shumë konfuzë. Kanë ndodhë shumë, shumë, shumëçka. Ishin gjënat shumë ma komplekse. Une kom qenë e bindun gjatë viteve të 90ta që na e kemi njëfarë superioriteti moral, dhe që përshembull, na kurrë nuk kishim bo diçka dhe s'kena bo. Po në të njëjtën kohë, për shembull, kur fillun mas luftës me i perzonë serbët prej shpiave, për me iu marrë shpiat.

Me kujtohet një epizod, një ngjarje, që më pat trondit jashtëzakonisht shumë, është një ngjarje, shumë herët ne mengjes, unë pritsha me ardhe me më marrë Jeffi me shku në terren, ka qene fundi i 99-tes qashtu, edhe një gru sërbe plakë, kojshike e hymjes tjetër, ishin çu disa fëmijë herët me shku në shkollë dhe e gujshin me guri, edhe për mu ka qenë qaq shqetësuese, edhe gruja u tut. A din, do qisi ngjarje, për mu kane qenë shumë të gerrditshme dhe shumë shqetësuese. Njërarë ngjarje që më pat bo kështu me mendu nacionalizmin edhe me mendu qat aspektin e nacionalizmit shovinist.

Krejt qat konfuzion, krejt qat krize, sidomos të mas luftes kam pasë nevojë me e kuptu ma thellë, me e shpërbo. Kam pas nje nevojë shumë të madhe mas luftës me marrë frymë, me ikë, me dalë prej Kosovës, ka qenë kështu njëfarë impulsi jashtëzakonisht i madh. Më kujtohet me profesorin Nait Vrezezin, profesorin e psikologjisë këtu, pata fol ma gjatë. Edhe ai m'ka thonë- ma pat dhonë një këshille shumë të mirë, ka thonë, tash krejt qito kujtime, krejt qito ngjarje, shtini në fijoje edhe kthehu në fakultet, edhe mandej kur, mandej i jep kuptim pak më vonë, po a din, duhesh kanjeherë në jetë, me i palu do ngjarje, do sene edhe... për me mujt me i kapercy.

E më kujtohet 99-ta ka qene shumë e vështirë për të gjithë, sepse s'kemi pasë uje, s'kemi pasë rrymë. Domethonë m'kujtohet edhe unë në fund 99tës, domethënë në fund t'99tës, sidomos që ajo periudha para Vitit të Ri ka qenë shumë shumë e rande emocionalisht. Unë vendosa me u kthy në fakultet, vendosa me i përfundu studimet dhe vendosa me apliku në master në New York. Dojsha me shku, e kom pas kështu si fiksim, dojsha me shku në Amerikë, në New York. Po dojsha me kry një herë fakultetin në UP.

Edhe ka qenë ndër kështu periudhat më të vështira. Periudha kur mëson dhe kur kthehesh mësim dhe unë isha krejt qito vjet, për çdo ditë, ka dymbëdhjetë orë ne ditë n'terren, n'punë. Nuk e di gjate krejt qatyre viteve a i kam pasë ndoshta dy-tri ditë të lira, dy-tri dite që s'kam punu e që s'jam kanë ne veprim. Kur shkunë këta para vitit të ri, ka qenë kështu një farë, une mbeta me gjithë qato përvoja dhe me gjitha qato ngjarje në kry tem dhe ishte shumë shtirë me i procesu, se gjatë krejt qatyne viteve të terrenit diqysh ka qenë, prej një ngjarje në ngjarjen tjetër.

Edhe nuk ka pas kështu, me kujtohet babi m'thojke vazhdimisht, me majtë shënime, ma bojke "Pse nuk po mbanë ditar?", por ka qenë shumë e rande me shkru, domethanë shumë e randë ka qenë për me i procesu dhe shumë e randë ka qenë për me, për shemull qaj akti me mbajt ditar, me mbajtë shënime, ish akt reflektiv edhe jashtë, ish akt shumë i pamundun për mu në atë kohë sepse unë nuk e kisha qat fuqi për mu ulë edhe me u marrë me krejt qato ndjenja. Kanë qenë, spo di qysh me thonë, na kemi qenë në masakra.

Shumë shpesh u dashtë ashtu me kapërcy njerëzit e vdekun me fotografu, me interpretu, me intervistu, me kqyrë kush jonë, me kqyrë çka ka ndodhë. Ka qenë krejt me kujtohet krejt qajo periudhe unë per shembull nuk kom qajtë asnjëherë. Shumë rrallë më kanë shku do lotë, po ka qenë një farë periudhe e njëfar mobilizimit, se diqysh ka qenë një farë gjendje ku ti se len veten me tregu ndjeshmëri, se kemi qenë diqysh si ushtarë, jena në betejë, edhe për mu ka qenë s'është e jemja, me qajte edhe me kukate aty.

E jemja është me rikonstrukt dhe me mbledhë sa më shumë fakte edhe t'dhana, me i përkthi që me mujt që ato me dalë jashtë. Edhe domethonë ka qenë kështu shumë i orientum rreth asaj se kush është personi, cka ka ndodhë, çka është ngjarja, me rikonstrukt, me raportu, edhe me vazhdu tash n'ngjarjen tjetër. Për mua mandej ka qenë edhe më e vështirë, sepse për shembull s'ka qenë përvoje e jemja, unë këta njerëz nuk i kom njoftë para se me vdek, a po? Është e çuditshme, përshembull, kur ti fillon tash me ia rikonstrukt dikujt jeten, apo ngjarjen a çka ka ndodhë në qat masakër, apo n'qat dite.

E në të njëjtën kohe, per ty hera e pare që po i sheh qata njerëz jane të vdekur. E plus na shumë shumë te ri edhe shumë...Për mua ka qenë krejt qajo periudhë, ndoshta hera e pare qe që po foli kaq shumë detale për këto sene. Ka qenë qajo mi shti në fijoka edhe me vazhdu tutje. Qai dimri i 99tës, ka qenë dimër, pa rryme, pa ujë, me një farë dhimte, me zhurme të madhe të agregatëve, gjeneratorëve ne Prishtinë.

Nje dimër i ftohtë, më kujtohet nëna ime me v'llaun e vogël kanë shku te nëna e saj, se ajo kish shtëpi, Edhe mujshin me u nxe me dru, unë e babi, Jetoni rrishim në Dardani dhe me kujtohet që flejshim me kapuça, nuk u deshshim, shkojshim me u la te gjyshja. Mu m'kujtohet keshtu tu u mundu me u kthy në mësim, tu e rrethu veten me plot qiri dhe të mundohu me lexu filozofi dhe sociologji, edhe në një farë mënyre, me gjet një farë mënyre për me i tejkalu krejt qato kujtime.

Noa Nikqi: A ju ka ndihmu pastaj kjo analiza sociologjike pak per me procesu, me kontekstualizu çka ka ndodhë?

Linda Gusia: Për mu në fillim ka qenë shumë i veshtire koncentrimi. Pata edhe bisedu me profesorin Nait Vrenezin, se ai ka qenë psikolog, dhe i thojsha, “Po, e kom shumë shumë veshtirë me lexu”. Qathere e kom pasë shumë vështirë, domethënë me lexu një faqe edhe më ka vyjtë kështu shumë përkushtim. Jo pse unë e kisha tash ngjarje që po më vijne, nuk më vijke kurrqjo në kuptimin si n’filma ashtu shumë dramatike, po veç ish vështirë mu koncentru. Ish vështirë mu kon vetë, po ishte ne te njëjtën kohë vështirë mu kon me njerëz tjerë.

Shumë ka qenë shumë, qato vite kanë qenë shumë të veshtira, po mendoj që ka qenë shumë mirë për mu që jam kthy në fakultet. Tash ish qajo shkëputja prej njëfarë, me t’jep filozofia dhe sociologjia, sociologjia sidomos mi ka jep do mjete kështu me i menu ngjarjet që kanë ndodhe në mënyrë ma konceptuale, po edhe me pasë qatfar distancën e shkëputjen, e për mu ka qenë e rëndësishme me e përfundu fakultetin këtu edhe mandej pata apliku me shku në New York. Edhe gjatë fundit të vitit 2002 i pata përmbledhë koxha shumë provimet ne UP edhe dojsja me dale.

Gjatë luftës e pata taku në Shkup, kur kemi qenë si refugjatë, ka qene një farë darkë e madhe me Tony Judt, me t’cilin mandej u pata njoftu shumë mirë edhe me akademikë dhe njerëz të tjerë të famshëm që patën ardhe në Shkup, gjate kohës së bombardimeve. Me kujtohet se kanë qenë një farë darke shumë e madhe, Bianca... ka qenë nje farë darke n’Shkup, që s'po më kujtohet me të kallëzu drejtën po e di që me patën thirre dhe e di që pata qenë aty dhe ka qenë Tony Judt. Edhe u patëm njoftu me Tony Judt prej NYU-së, edhe patëm diskutu shumë Hana Arendt, m’kujtohet që e kena diskutu në mënyrë të veçantë edhe banalitetin e së keqes, edhe e di që ka qenë shumë i impresionum. Edhe m'pat thonë që kur kryhet lufta, nëse po ma merr mendja, me ju lajmëru, jam e interesume me shku ne NYU.

Më kujtohet qëka qenë kështu si, kur kryhet lufta, ne mes bombardimit, ka qenë diqysh si një far asi informate që nuk e pata marrë shumë seriozisht, po mandej, mas dy vjetëve, tri vjetëve gati, pata fillu me apliku nëpër shkolla. Pata apliku në shumë shkolla në Amerikë për MA, ka qenë këtu edhe një far Ron Brown, jepshin bursa. Po nuk jepshin bursa për sociologji, filozofi, shkenca sociale, jepeshin bursa më shumë për juridik, ekonomik.

E une pernime dojsja me shku me vazhdu me studiu, se më duke se çashtu jam duke, në njëfarë mënyre tuj procesu, edhe jam në një farë mënyre tu e kuptu cka ka ndodh në Kosovë. E kisha njëfarë shtytje dhe njëfarë nevoje shumë t’madhe me i artikulu më qartë, sidomos me kuptu qat pjesën gjatë

luftës dhe mas luftës. Krejt qajo dhunë, krejt qajo vrazhdësi, domethënë kisha nevojë me i kuptu. Ndjejsha që kam nevojë me lexu, dhe mu duke që tu lexu, pa marrë parasysh sa vështirë ka qenë në fillim, mu duke qe jam tu i procesu edhe përvojat e mia. Edhe mandej domethënë qështu, u pata pranu në dy-tri universitete në Amerikë edhe në NYU u pata pranu poashtu.

Mandej kur e kam pasë qat, e pata kry online këtu dhe e pata kry n'Shkup TOEFL edhe GRE. Në 2001-ten e pata marrë lajmin qe jam pranu n'NYU. E pata lajmeru edhe e pata gjetë kontaktin e Tony Judt. Toni Judt ka qenë qatëherë udhëheqësi i Remarque Institute te NYU-se, pata marrë si nje far si burse prej Tony Judt edhe Remarque Institute, edhe e kom pase një tavolinë aty në Remarque Institute. Ka qenë e jashtëzakonshme për mu si mundësi me qenë ne NYU, po me qenë ne NYU me dikon si Tony Judt.

Mandej aty në Remarque Institute me kujtohet në semestrin e dytë gjatë nëntorit ka qenë edhe Richard Sennett. Ai kish veç kështu studenta të doktoraturës. Po tu u taku aty në Remarque Institute, ku e kisha une një tavolinë edhe një hapësinë n'mes t'mësimit. Me pate thirre në klasë të vet dhe mandej e ka pas një klasë me Craig Calhoun. Më kujtohet që qato kanë qenë kështu do përvoja formative. Tash unë e kisha profesor Craig Calhoun, i cili e kish shkru librin e famshëm për radikalizëm edhe librin e famshëm për nacionalizëm, librin e famshëm për hapësirat publike.

Richard Senett poashtu u konë kshtu si një pervojë e jashtëzakonshme. Më kujtohet që në NYU, në Prishtinë jom kon prej atyre studenteve që fol shumë shumë. Kur pata shku ne NYU mu duke që sa shume kom me m'su, sa shumë kom me kompensu. Edhe më kujtohet Richard Sennett ton kohen ma bojke, "cka je mshefë aty n'fund, hajde ulu këtu". Edhe kam qenë qaj inkurajimi dhe fati jam i madh. Fati jem jashtëzakonisht i madh me pasë mundësi në një farë mënyre me qenë jashta kontekstit të Kosovës.

Natyrisht s'te kallëzova që në fakt une kam shku në New York kah fundi i gushtit, 20 gusht po më doket, qashtu dicka, 2001. Edhe dy-tri javë masi që kom shku, ka ndodhë 9/11. Ajo ka qenë po ashtu njëfarë përvoje tjetër jashtëzakonisht e rëndësishme për mu se e sheh, domethonë, Amerika ish per ne një far vendi ku shumë ngjarje nuk ndodhin. Kishim shumë iluzione prej Kosoves për cka është Amerika. Kur kam shku ne Amerike e kom pa racizmin, i kom pa pabarazite, varfëritë, dhe shumë sene të tjera n'New York. Domethonë 9/11 ka qenë prej atyne ngjarjeve të tmerrshme.

Noa Nikqi: Qysh jeni ni personalisht që keni shku prej tragjedisë n'tragjedi?

Linda Gusia: Qajo ka qenë njo prej seneve kryesore që më thoshin njerëzit, ma bojshin ty po te ndjek kështu drama se manej, manej në ç'atë kohë.. Menjëherë, pas luftës, Chai Vasarhelyi edhe Hugo paten ardhe me bo një film - "Normal life". Edhe Chai, kur e ka marrë vesh që unë po shkoj në New York, më ka thane deri sa stabilizohesh, mundesh me nejt në shtator, në 66th street në sh'pi te Chai.

Edhe mu m'kujtohet, u nisa për me shku shume heret për me shku në fakultet. Unë nissha shumë herët prej shtëpise, se unë isha ne qato javët e para, dhe u ndijsha shumë jo adekuate, shumë e

papërgatitun, edhe kisha nevojë vazhdimisht me mësu, rrijsha ton ditën në bibliotekë se mu duke vetja që nuk po di kurgjo, nuk mujsha me percjellë kurgjo, edhe u nijsha që kom nevojë shumë me kompenzu për me qenë në qato klasa. E më kujtohet, u nisa me marrë trenin për me shku ne shkollë edhe kisha dal me papuçe. Po të njëjtën kohë tu dasht me hi në tren, do njerez po më kapin edhe po thojne “*They attacked us*”.

Përvoja në New York, tash me shku prej Prishtinës në New Jork ka qenë kështu e jashtëzakonshme se tash ne New York kish plot kështu njerëz homeless, njerëz të ndryshëm, që në Prishtinë nuk i sheh, je shumë e izolome. Edhe New Yorku, ka qenë “khu sa njeri këtu”... Edhe po kthena unë në shtëpi te Chai, edhe baba i Chai po ma bon hajde, ish tu kqyr televizor dhe p’e shoh aeroplanin e dytë tu hi në Twin Towr. Edhe une po i thom “A është pernime qikjo?”. Qështu dhe mandej tmerr, po dalim me to dhe me Chai edhe me krejt, po dalim si në fund të rrugës, ish si rruge ku kalojshin veturat dhe poshtë u shihke e tymi ashtu. Mandej u nderprene telefonat-

Noa Nikqi: Domethene, keni mund me e pa prej aty?

Linda Gusia: Po, po kemi mujt me pa. Për mu tymi ka qenë kështu shumë, unë sa ika prej luftës, edhe për me shku në Amerikë ish ikje prej krejt, prej tymit, prej dhunës e ka qenë kështu shumë...”wow, cka ndodhi?”. Mandej m’kujtohet, për ni kohe, nuk kanë punu telefonat. M’kujtohet, momentin e parë që e kam marrë telefonin me i thirrë nanen e baben, e me i tregu, nana me tha “Kthehu menjëherë në shtëpi, menjëherë!” Edhe ma bojke “Nuk është- u bo hallakame edhe atje, ma mire e ki ketu, u kry lufta”. Diqysh, ka qenë qajo ndjenja që qito ngjarje po më njekin.

Me kujtohet patëm shku në darkë te Tony Judt, i thirrke njerëzt n’darke qështu. Kemi qenë na të Evropës, plot ka pasë të Evropës Lindore, aty studentë të ndryshme që punojshin me Tonin, edhe diskutojshim, domethonë diskutojshim per flamujt, patriotizmin e amerikanëve, rreth qasaj ngjarjeje. Po me përvojën tem të Kosovës, mandej ka qene shumë interesant me kthy qat përvojë në klasë dhe me disku po të njëjtën kohë me marrë pjesë në cka po di une, protesta, lufte.

Tash e kisha krejt një përvojë që e kisha prej Prishtinës, ne 9/11, në ngjarjet e New Jorkut. Po, që ish interesant dhe e bojke mandej edhe dijen time, t’bazume në përvojë të lidhun me që ato që mësojshim ne klasë edhe mandej- në një farë mënyre të çuditshme 9/11 edhe ngjarjet e 11 shtatorit ma japin mu njëfarë, si me thonë agjensioni në interpretimin, se tash unë për herë të parë isha si i jashtëmi te qajo kulture.

Po per shembull, unë e shihja qysh janë tu reagu njerëzit, flamujt, edhe kisha të njoftuna, të ngjashme, edhe na qështu. E kisha njëfarë, krejt ne suaza tjera, në mënyrë tjetër, por një farë mënyre të re, për me pa qat farë universalitetin e konfliktit, dhunës, luftës, edhe ngjashmërive, dallimeve, te gjitha këtyne. Kështu që mendoj që edhe qajo përvojë ka qenë, poashtu njëfarë përvoje që i jep njëfarë kthese tjetër tash edhe pervojes teme në universitet, se ish pak ma ndryshe, ma tjetër.

Qishtu, mandej *the rest is history*. Kom mbetë në qatfar loop-in e nevojës për me kuptu, për me interpretu, po edhe me pa se qysh mundën që ato përvoja t'ndryshme, të vendeve t'ndryshme, me udhëtu. Për shembull une tash sot jom shumë e interesume ma shumë në përvoja të lëvizjeve shoqërore, në menyra të ndryshme të mobilitetit social edhe te lëvizjeve shoqërore, të cilat munden me sjellë dhe me e bo dallimin. Keshtu që, mendoj që qajo është qajo trajektorja dhe qëto ngjarjet e e rinisë së hershme temes qe më kanë çuar ne qit drejtim.